

RELACION

OBJEKTI: NDERTIMI I UJËSJELLËSIT NË FSHATIN VARIBOP NJËSIA ADMINISTRATIVE ÇAKRAN, FIER

Fshati Varibop shtrihet ne zonat kodrinore te Fierit, ne jug te tij. Rrjeti i ujesjellesit ne kete fshat eshte i amortizuar dhe pothuajse nuk eshte ne gjendje pune. Ai momentalish arrin te jap prurjen 3 l/sek, e pamjaftueshme kjo per furnizimin me uje te pijshem per gjendjen aktuale te popullsisë. Ne baze te normave ditore te perdorim te ujit ne zonat e fshatrave sot, eshte llogaritur qe kerkesa per uje eshte afersisht 6 l/sek. Per garantimin e kesaj sasie uji eshte menduar te hapet nje pus i ri ne zonen e puseve te tjere ekzistues qe furnizojne ujesjellesat e tjere te fshatrave si: Patos, Krapsi dhe Plyku. Pusi shtrihet ne zonen afer lumit Vjosa dhe ka kuote te ulet ne krahasim me fshatin dhe kryesisht depon ekzistuese qe eshte parashikuar te rikonstruktohet dhe te perdoret per rregullimin e prurjes ne ujesjellesin e ri. Ndersa per garantimin e presionit te nevojshem per ngritjen mekanike te ujit ne kuoten e depos eshte menduar te vendoset nje pompe zhytese ne pus me fuqi te llogaritur prej 37 kW. Fshati Varibop do te kete dy depo te parashikuar per shperndarjen e ujit ne prurjen dhe presionin e duhur per dy zona per secilen. Rrjetet e furnizimit te depove dhe rrjetet shperndarese jane paraqitur me detaje ne vizatime. Ne hyrje te fshatit eshte menduar te behet nje degezim i linjes kryesore prej celiku, ku drejtimi djathtas do te furnizoje fshatin Varibop ndersa ai majtas do te furnizoje fshatin Vjose, duke u lidhur me linjen ekzistuese afersisht pas 750m. Linja kryesore e dergimit do te jete prej celiku me trashesi 4.5mm per te duruar presionin qe jep pompa dhe deri ne degezim ai do te cazhdoj pa ndryshim diametri dhe trashesi paretesh. Ai do te izolohehet per te mos u amortizuar prej oksidimit me kohen. Ne degezimin e dy fshatrave ai do ndahet ne dy diametra perkatesisht me 63mm

per Vjosen dhe 125mm per Varibopin. Tubot e perdorura do te jene pre HDPE te tipit PE100 dhe te presioni te lejuar te punes 20atm. Per arsye ekonomike, linja qe furnizon depon 1 ne kuotat me te larta pre pikete 1000m te degezimit te Varibopit, do te vazhdoje me Tub PE100 me diameter nominal 110mm dhe presion 10atm. Depoja e dyte ne kuotat me te ulta do te furnizohet me uje prej depos 1, te lidhura me tub PE DN110 Pn10atm. Te dyja depot, me volum prej 100m³, kane zonat e tyre perkatese qe operojne dhe rrjetin e tyre shperndares, i cili eshte i pajisur me tubo me diameter te llogaritur per te transportuar prurjet perkatese dhe te pajisur me kolektor per te bere shperndarjen ne pika te ndryshme. Per manovrimin e rrjetit jane ndertuar puseta kontrolli kryesisht ne degezime dhe puseta per funksionim e rregullt te tij. Pusetat jane vendosur ne pikat ku linja kerkon te nxjerre ajrin dhe ne pikat ku behet shkarkimi I linjes ne raste avarish dhe nderhyrjesh. Puseta kryesore eshte ne degezimin e dy fshatrave ,dhe linjat qe ndahen jane te pajisura me saracineska, mates uji dhe mates presioni. Detajet per pajisje me valvula ajrimi, drenazhi dhe valvula mbyllese jane paraqitur ne planimetri dhe ne detaje. Puseta jane menduar te ndertohen prej betoni te armuar dhe ne permasa te tilla qe lejojne punen ne tubacionet brenda tyre.



Punoi: Ing. Elvis Papaj

Ing. Laert Tanku